



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Dalës-Izlazës

Nr. VIII-170
Br.

Data 09.06.2021
Datum

OBILIQ-OBILIC



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO - KOMUNA E OBILIQIT-KOSOVË / OPŠTINA OBILIC -
KOSOVO / MUNICIPALITY OF OBILIQ - KOSOVO

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore

Në bazë të ligjit për Zyrtarët Publik me Nr. 06/L-114, Kapitulli V neni 67 dhe 68, si dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr. 04/2020 për procedurat dhe kriteret e zgjedhjes së Drejtorit dhe neni 18 e 19 të Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare – Obiliq, Autorizimit të Kryetarit të Komunës, II-257 të datës 08.06.2021 Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale shpallë këtë:

K O N K U R S PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS

Pozita:Drejtore i QKMF-Komuna e Obiliq

Koeficienti: H - 944/1

Lloji i pozitës:Me afat të caktuar (mandat 4 vjeçar)

Kategoria Funktionale: Nivel drejtues

Orari i Punës: 40 orë në javë

Titulli i Mbikëqyrësit: Drejtore i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenie Sociale

Data e Njoftimit : 09.06.2021

Afati për aplikim : 15 ditë nga data 09.07.2021 deri me dt. 23.07.2021

DETYRAT KRYESORE TË PUNËS:

- Siguron Ligjshmërinë dhe punën profesionale në QKMF, e cila duhet të udhëhiqet në pajtim me dispozitat e Statutit të QKMF-së;
- Është përgjegjës për përkujdesjen efektive të Shëndetësisë parësore për të gjithë banorët e Komunës së Obiliqit;
- Në pajtim me Politikën shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi në Kosovë dhe Strategjinë e Kujdesit parësor shëndetësor i propozon Drejtorit të Drejtoratit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale planin e punës dhe buxhetin e QKMF-së për vitin vijues;
- Kujdeset për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës;
- Kujdeset për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të personelit të QKMF-së;
- Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së;
- Ushtron të drejta dhe autorizime dhe mban përgjegjësi të tjera në përputhje me dispozitat ligjore dhe aktet tjera që kanë të bëjnë me implementimin e Mjekësisë Familjare.

KUSHTET:

- Aftësi të plotë për përmbushjen e detyrave të vendit të punës, me orar të plotë pa kufizime dhe pengesa ligjore;
- Përgatitje universitare: Fakulteti i Mjekësisë- Specialist i mjekësisë familjare,
- Aftësi të mira analitike dhe komunikuese;
- Të ketë pesë vite (5) përvojë pune nga fusha e menaxhimit dhe zbatimit të mjekësisë familjare;
- Njohja e gjuhës angleze e dëshirueshme;
- Njohuri të punës me kompjuter;
- Aftësi të tjera që shërbejnë për kryerjen e detyrave të punës dhe raport kolegjial në marrëdhënie të punës.

DOKUMENTET E NEVOJSHME PER APLIKIM:

- Dokumentet personale;
- Diplomë universitare - Specialist i mjekësisë familjare
- Licencë pune e lëshuar nga organi kompetent
- Certifikata që nuk është nën hetime nga Gjykata;
- Dëshmi për përvojë pune në shëndetësi;
- Vërtetim mbi gjendjen shëndetësore të lëshuar nga institucioni publik shëndetësor.
-

Informata të përgjithshme:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen së bashku me dokumentet e kompletuara në Qendrën për Shërbim me Qytetar në Komunën e Obiliqit.

Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura. Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen.

Dokumentacioni i kandidatëve të cilët nuk i plotësojnë kushtet e konkursit nuk do të shqyrtohet, ndërsa në intervistë do të ftohen vetëm kandidatët nga lista e ngushtë.

Të gjithë kandidatët që kanë mbaruar studimet jashtë Shtetit të Republikës së Kosovës, duhen që diplomat e tyre (gradat universitare të fituara) të jenë të njohura nga Ministria e Arsimit.

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale:

Vlora Kabashi
.....
Vlora Kabashi

